



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/ 90

Datë: 15.02.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2022.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport .
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për orar të punës së subjekteve afariste.
6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 20.01.2023 dhe filloi në ora: 09:50. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Zyrtari ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Gentianë Hoti, Hamit Lima, Veton Zogaj, Arlindë Rudi, përfaqësuesi nga OSBE-ja dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi gjashtë antarë, një anëtarë mungon me leje dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. E kemi dhe një pikë të rendit të ditës që propozoj që të futet në rend të ditës që është Raporti i punës së Komitetit për Barazi Gjinore. Kush është për që kjo pikë të hyjë në rend të ditës?

Me vota unanime, kjo pikë futet në rend të ditës.

E hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Nëse nuk ka diskutues, kush është për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Me vota unanime, miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2022. E kemi bërë një përmbledhje të punës dhe aktivitetit të Kuvendit për vitin 2022. Përpilimi dhe hartimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal, është prezantimi i punës institucionale, përballë këshilltarëve si dhe qytetarëve mbi transparencën dhe llogaridhënien ndaj tyre. Kuvendi Komunal në Malishevë ka mbajtur mbledhje të rregullta, të jashtëzakonshme si dhe urgjente. Kuvendi punën e tij e bazon në përmbushjen e detyrave, në marrjen e vendimeve, nxjerrjen e rregulloreve, si dhe duke u përgjigjur të gjitha kërkesave të qytetarëve të cilat i drejtohen Kuvendit, më shumë përgjegjësi dhe transparencë konform ligjeve dhe akteve nënligjore. Raporti i punës për vitin 2022, vë në pah efikasitetin e Kuvendit Komunal, i cili gjatë gjithë kohës ka qenë aktiv, gjatë periudhës Janar- Dhjetor. Kuvendi ka pasur shumë detyra, obligime e përgjegjësi, duke u marrë më informimin, shqyrtimin e miratimin e raporteve të ndryshme që vijnë nga Ekzekutivi i Komunës. Poashtu, kuvendi ka trajtuar edhe çështje tjera nga fusha të ndryshme të cilat i janë drejtuar atij, për projekte, për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore në toka ndërtimore, dhënjën e pronave publike në shfrytëzim, për ndihma financiare, e për investime të shumta.

Në kuadër të Kuvendi janë konsitu edhe komitetet obligative dhe ato joobligative, të cilat kanë mbajtur mbledhje për të punuar në përmirësimin e nevojave të qytetarëve, për trajtim të barabartë, ndërmarrjen e veprimeve konkrete, dhe përmbushjen e detyrave të veta, varësishtë nga komiteti dhe funksioni i tyre, duke nxjerr rekomandime të shumta të cilat i kanë drejtuar në Kuvend për miratim, për të vazhduar më pas si referenca tek drejtorët e ekzekutivit komunal, që t'i zbatojnë ato rekomandime.

Kuvendi poashtu ka aprovuar edhe projekt-buxhetin për vitin fiskal 2023, duke e bazuar gjithë buxhetin aty ku ka nevojë për investime komuna e Malishevës. Kuvendi Komunal, në vitin 2022 ka mbajtur: 10 seanca të rregullta, 3 të jashtëzakonshme. 2 urgjente, 3 solemne dhe 2 seanca përkujtimore. Në mbledhje Kuvendi ka nxjerrur 5 rregullore, 32 vendime si dhe rekomandime sipas kërkesave të parashtruara nga komitetet si dhe anëtarët e Kuvendit Komunal.

Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Raportin e kam lexuar dhe e kam krahasuar me planifikimin e punës së Kuvendit dhe në përgjithësi është i barabart me planifikimin që e kemi pasur, në përjashtim me disa pika që i kam pasur në rend të ditës. Ajo që desha të ngris është qështja e Komiteteve, që dhe pse i kemi themeluar me vonesë, kanë mbajtur një numër të konsiderueshëm të mbledhjeve dhe kanë arritur kriterin që t'i kenë 6 mbledhje. Unë kam një pyetje për drejtorin Blerim. A janë përfunduar pagesat e këtyre Komiteteve dhe nëse nuk janë përfunduar dua ta di se kur përfundohen obligimet?

Prej të gjitha Komiteteve, sa e di vetëm Komiteti i Urbanizmit nuk ka mbajtur mbledhje dhe duhet patjetër të rifunksionalizohet ky Komitet.

Te vendimet e Kuvendit dhe të KPF-së, për ndihmë financiare ndoshta është më mirë të vendoset dhe shuma totale.

Uroj që këtë vit të kemi një lloj dakordimi më të mirë pozitë-opozit dhe ne si VV jemi munduar me sjellë një lloj fryme pak më ndryshe se në të kaluarën, duke shpresuar që gjejmë mirëkuptim dhe të pushteti në këtë rast, mirëpo kemi pasur telashe, sidomos në seancën e fundit që u shpërfaq më së miri ajo. Uroj që mos të kemi aso sjellje, sepse nuk na bënë nder as neve si kuvendar, as subjektit të cilit i takojm dhe as qytetarëve. Së pari t'i je kryesuesi i gjithë neve, sesa i takon një subjekti politikë dhe merri praktiat dhe të kuvendeve të tjera. Uroj që nuk ke me pas këso lloj problemesh dhe mos u ndiko nga askush.

Argjend Thaçi: Vetoni, Kryesuesi është i obliguar me thirrur seancë në të gjitha rastet kur ka kushte për mbajtjen e seancës dhe nuk mundet me mbajt seancë kur nuk ka kushte, duke filluar nga kushtet teknike të kourumit dhe qështjeve të tjera. Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Për dallim nga Vetoni, unë kam vetëm lavdata për punën e Kuvendit, me theks të veçantë për Kryesuesin. Dhe pse e kemi nisur Kuvendin me vonesë derisa u zgjedh kryesuesi, pastaj Komitetit tjera, prapë se prapë ka vazhduar mirë dhe ka rregullore të miratuara këtë vit të cilat nuk kanë qenë viteve të kaluara dhe kjo është njëra prej punëve që është realizuar me sukses këtë vit.

Kryesues, e kam një vërejtje te seancat solemne, që shumica e anëtarët të opozitës nuk marrin pjesë në këtë seanca. Të kemi një list dhe të jetë obligative që të jemi pjesmarrës në ato seanca.

Gentianë Hoti: Në seancën e fundit të ndarjeve të çmimeve kemi qenë vetëm tre ose katër antarë dhe përderisa i kemi votuar këto çmime pse mos me qenë dhe pjesmarrës në atë seancë.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka diskutues tjerë, e hedhim në votim. Kush është për që Raporti i Kuvendit për vitin 2022, të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë është rekomanduar për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport. Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, profi Januz dhe të gjithë anëtarët që janë në këtë Komitet kanë bërë një punë të mirë, kanë vizituar shumë shkolla. Ajo çka më ka penguar mua është që në çdo pjesë që kanë bërë takime, psh me DKA-në drejtoresha nuk ishte prezent dhe e ka dërguar një përfaqësues të saj dhe Komiteti nuk e ka pranuar dhe nuk e kanë mbajtur mbledhjen. Unë nuk e di sa kanë të drejtë ata ta anulojnë mbledhjen për shkak që nuk është drejtoresha aty, meqenëse e ka dërguar përfaqësuesin e saj.

Pastaj e kanë mbajtur një mbledhje dhe e kanë cekur që në testet që kanë qenë testi i arritshmëris dhe testi i maturës, drejtoresha nuk ka qenë prezent, por vetëm përfaqësuesit. Kjo është e pakuptimt që ata mos t'i mbajn mbledhjet për shkak se ajo nuk është prezent, sepse ata është dashur të kryejnë punën e tyre ta mbajn mbledhjen, t'i raportojn zyrtarit dhe zyrtari i raporton

drejtorisë. Ne e dimë fluksin e madh të punëve që ka DKA-ja, nuk do të thotë që mund të merr pjesë në të gjitha mbledhjet dhe i gjithë raporti është i shënuar ishte prezent, nuk ishte prezent dhe kjo mua më është dukur e tepërt.

Këtu është e cekur dhe qështja e ngrohjes në disa shkolla, unë po flas për shkollën Hamdi Berisha ku unë punoj, qështja e ngrohjes është normaluar dhe nuk kemi më probleme. Aty problemi është vetëm me paisjet me printer dhe letër të bardh, vetëm për këto duhet të bëhet një zgjidhje për letër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Në gjitha Raportin është shënuar ka qenë drejtoresha prezent, nuk ka qenë prezent. Zakonisht kur po thirren mbledhjet së pari duhet të kenë një konsultim pasi kanë pasur me thirr drejtoreshën në mbledhje. Sa i përket këtyre kritikave dhe ne pajtohemi që letra ka qenë problem në shumicën e shkollave. Sa i përket vizitave të këtij Komiteti i përgëzoj, sepse kanë bërë një punë të mirë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kur e sheh përbërjen e Komitetit, që janë të gjithë anëtarët prej asaj fushe, pret shumë më shumë. Mirë që është bërë vizita në shkolla, i nxjerr në pah disa mangësi ose disa përparësi. Kur i kemi themeluar këto Komitete ju kemi dhënë një farë detyre që këta me qenë dhe këshilldhënës dhe me sjellë rekomandime për drejtorit përkatëse. Po e shohë që ka bërë një numër të madh të vizitave, takime me drejtor të shkollave, realisht më shumë se sa një raport formal, numri i nxënësve, të klasave, të mësimitdhënësve dhe nuk është ndalur te qështjet që ndikojnë direkt në ngritjen e cilësisë.

Pas gjithë këtij raporti po i shohim vetëm tre rekomandime që përmenden: përgjegjësi më të madhe nga drejtoritë relevante. Është dashur të ceken qfarë përgjegjësie është kërkuar nga ky Komitet ose nëse nuk ka pasur përgjegjësi është dashur të ceken cilat punë kanë qenë neglizhente që ka pasur pengesë prej drejtorive.

Ofrim i transparencës dhe qasje në dokumentet zyrtare, pa pasur nevojë që të kërkohet me procedurë ligjore. Nëse kanë bërë kërkesa për qështje të caktuara e nuk i kanë marrur është mirë me i cek cilat janë ato.

Të trajtohet Q.K “Kujtim Krasniqi” si shkollë e Malishevës, sepse në konkursin e fundit të

shpallur nga DKA-ja, për pranimin e nxënësve, kjo shkollë nuk figuronte askund. Komuna nuk mund ta trajtojë një shkollë në mënyrë më të veçantë, kur janë dhe 38 shkolla tjera. Është jo korrekte me këto rekomandime.

Unë pres prej secilit Komitet që me nxjerr rekomandime më të mira në këto Raportekur të na vinë. Unë më shumë pres të ndalen te konkurset e pranimeve si kanë shkuar, a janë përfillur kriteret akademike, a janë punësuar njerëz adekuat, aktivitet jo shkollorë të cilat nxisin ngritjen e cilësisë në arsim. Këta janë njerëz të fushës së arsimit dhe askund në raport nuk e kanë vendosur për aktivitetin jashtë shkollor. Lavdata te vizitat që i ka bërë, mirëpo te rekomandimet është shumë i mangët.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Te Qendra e Kompetenzës, ka qenë kërkesa e tyre që të trajtohet njejtë sikur shkollat e tjera. Unë kam punuar në Qendrën e Kompetencës dhe e di si shkon, dhe asnjëherë nuk i kemi rekomanduar nxënësit që të shkojnë vetëm në “Hamdi Berisha” ose në Kijevë, sepse nxënësit zgjedhin vetë se ku dëshirojnë të shkojnë. Vitin e fundit mendoj që Qendra e Kompetencës ka pasur një rritje të numrit të nxënësve, për shkak se është bërë dhe kriteri më i mirë në Gjimazin “Hamdi Berisha”, në përjashtim të disa rastve specifike që i kemi pranuar me notë 3, përndryshe të gjithë të tjerët janë me sukses të shumë mirë ose shkelqyshëm dhe kjo e ka ndihmuar Qendrën e Kompetencës dhe shkollën në Kijevë.

Është dashur në Raport të ceken dhe punët e mira që janë bërë, psh klasa tjetër që është hapur për mjekësi në Kijevë, të shkohet të vizitohet sepse është një degë e re dhe të shikohet se a i kanë të gjitha mjetet dhe sa është numri i nxënësve aty.

Argjend Thaçi: Kush është Raportit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport të rekomandohet për Kuvend?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 5 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Rregulloren për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme e kemi dërguar në Ministri dhe Ministria e ka kthyer për plotësim ndryshim në tre pika dhe ne jemi të obliguar me sjellë në asamble prapë me ato ndryshime. Ndryshimet janë të hijezuene, psh për ambula është shtuar QRK nr.07/2021 mbi pezullimin e shërbimeve komunale për mbledhjen e detyrime të pa paguara të tatimit në pronë . Në faqen 4 kriteret e përgjithshme dhe dokumentet për aplikim, është dashur të shtohet te paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 vërtetimi i tatimit në pronë duhet të kërkohet me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borgje aktuale pashlyera nga tatimi në pronë. Dhe në planifikim të buxhetit për këtë vit kalendarik shuma e mjeteve që është e planifikuar për ndarjen e këtyre subvencioneve neni 13 faqe 9 paragrafi 2, vlera totale për subvencionimin NVM është planifikuar të jetë 200.000 E. Kërkoj që këto tre ndryshime ti rekomandoni për Kuvend. Sa përket pagesës së Komiteteve, besoj që në muajin shkurt do fillojmë me shlyerjen e obligimeve për Komitetet dhe Komisionet nga Kuvendi.

Argjend Thaçi: Kush është për që Rregullorja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për orar të punës së subjekteve afariste

Veton Zogaj: A e rekomandojmë për Kuvend, pastaj në kuvend japim sugjerimet tona.

Argjend Thaçi: Kush është për që Rregullorja për orar të punës së subjekteve afariste të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 316 raste të vdekjes dhe nga totali i 316 rasteve, 12 raste kanë qenë pa pagesë, ndërsa 304 raste me pagesë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë kam shumë vërejtje për këtë Raport. Jam njëri prej shumë asambleistëve të tjerë që kam kërkuar që të na vjen ky Raport para se të ju vazhdohet kontrata për vitin 2023, ndërsa e kanë sjellur këtë Raport mbrapa. Një rast i cili më ka prekur është një i afërm i imi i cili ka vdekur në Spanjë dhe pas një jave ka ardhur me arkivol dhe këtu shënon që e ka marr arkivolin wshtw pwr tw ardhur keq qw nw kwso raste tw bwhen keqperdorime.

Unë i kam evident diku 13 persona të cilët nuk e kanë marrur komplet shërbimin. Unë dhe në Kuvend do e them që me ju ndërpre kontrata, sepse ka keqperdorime.

Kryesues, një vërejtje e kam kur t'i sjellin dokumentet Bashkësia Islame në komunë, të mos i sjellin këtu me këto shkrime arabe.

Hamit Lima: Unë dhe në mbledhjen e kaluar kam thënë që me bërë si rregull që Bashkësia Islame kur ta përfundon ceremonin e varrimit t'i ketw tre kopje, nje për vete, një për komunën dhe një palës.

Argjend Thaçi: Kush është për, qw Raporti i shpenzimeve të varrimit për vitin 2022 tw rekomandohet pwr Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Barazi

Gjinore. Meqenëse në Kuvend i kemi tre anëtarë, po e rekomandojm për Kuvend. Kush është për?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë te pika të ndryshme. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: E kemi pasur një kërkesë që ka ardhur prej kryesis së fshatit Bardhë dhe e kemi rekomanduar te Drejtoria për Kadastër dhe Urbanizëm për me dhënë pelqimin, dua ta di a është shkuar ajo kërkesë apo jo.

Muharrem Morina: Te unë është shkresa dhe ende nuk e kemi shqyrtuar.

Argjend Thaçi: Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për pjesmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora: 11:00.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

